



DPAP

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Nr. 2055 prot.

Tiranë, më 25. 6. 2025

Njoftim: LISTA E APLIKIMEVE TË PËRFITUESE DHE DOKUMENTET E KËRKUARA SIPAS MASËS PËRKATËSE.

Bazuar në VKM-së nr. 150, datë 6.3.2025, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2025" dhe Udhëzimin Nr.14 i ndryshuar, datë 28.03.2025 i MBZHR dhe MF "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", Kreun VII "Procedurat që ndiqet për përzgjedhjen, verifikimin dhe pagesat për masat mbështetëse me nr. 1-7", përkatësisht pika 3, "Me përfundimin e aplikimeve dhe kontrollit administrativ të dokumenteve që gjenerohen online, AZHBR shpall listën e aplikimeve të përfituesve dhe dokumentet e kërkuara sipas masës përkatëse", me të dhënat si më poshtë:

MASA 1: "Për tufën bazë të matrikulluar të krerëve të gjedhit" janë kualifikuar 3971 aplikime;

MASA 2: "Për tufën bazë të matrikulluar të krerëve të të imtave" janë kualifikuar 5526 aplikime;

MASA 3: "Për mbarështimin e Bletarisë" janë kualifikuar 4324 aplikime;

MASA 4: "Mbështetje për serat dhe kontrolli biologjik" janë kualifikuar 837 aplikime;

MASA 5: "Mbështetje për Bimë Aromatike dhe Medicinale" janë kualifikuar 1407 aplikime;

MASA 6: "Mbështetje për Fermat Organike" janë kualifikuar 203 aplikime;

MASA 7: "Mbështetje për Fermat me certifikimin Global GAP", janë kualifikuar 26 aplikime.

Të gjitha aplikimet sipas subjekteve/aplikantëve që gjenden në listat e aplikimeve të kualifikuara për masën 1-7 dhe për rastet që kërkohet dokumenti sipas masës përkatëse dhe që kanë nevojë për dokumente shtesë sipas tabelave të mëposhtme, fermerët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente të plota brenda 30 ditëve kalendarike pas publikimit të listave në faqen zyrtare: www.azhbr.gov.al.

Mosplotësimi i kriterëve të përfitueshmërisë brenda afatit të përcaktuar, është kriter skualifikimi

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ardita Kuçi

